



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr. 296 datë 30.05.2023

“PËR
DHËNIE LEJE TË PAPAGUAR GJYQTARES {...}”

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen plenare të datës 30.05.2023, si u njoh me materialet e çështjes, relacionin “ *Mbi projekt-vendimin mbi kërkesën e gjyqtares {...} për dhënie leje të papaguar*”, për gatitur nga relatorja, znj. Yllka Rupa, si dhe pasi shqyrtoi propozimin e Komisionit për Vlerësimin e Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale,

VËREN:

1. FAKTET E ÇËSHTJES

1.1 Më datë 23.05.2023 znj. {...}, gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, ka paraqitur në rrugë elektronike “Kërkesë për dhënie leje të papaguar për periudhën nga data 01.06.2023 deri në datë 01.06.2025”, protokolluar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me nr. 2986 prot., datë 23.05.2023.

1.2 Në kërkesën me shkrim znj. {...} parashtron (citoj): “*Unë magjistrate {...} ushtroj detyrën si Gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Me vendimin nr. 208, datë 20.05.2021 nga Këshilli i Lartë Gjyqësor është miratuar kërkesa për dhënien e lejes së papaguar për një periudhë 1 (një) vjeçare, e cila ka filluar në datë 01.06.2021. Leja e sipërcituar është zgjatur me vendimin nr. 200, datë 31.05.2022, deri në datën 01.06.2023. Shkaqet për të cilat u zgjat leja lidheshin me ushtrimin e të drejtës për të krijuar familje. Duke qenë se leja mbaron në datë 01.06.2023, parashtrroj para jush këtë kërkesë për dhënie leje të papaguar për një periudhë 2 dy-vjeçare. Kërkesa ime për përfitim të lejes së papaguar ka si shkak ardhjen në jetë të vajzës time me datë 12.04.2023, e cila aktualisht është në moshën 6 javëshe, pra ende nuk ka mbushur dy muaj jetë. Arsyet për të cilat unë pretendoj përfitimin nga leja e papaguar lidhen me detyrimin familjar për rritjen dhe përkujdesjen ndaj fëmijës së mitur, e cila ende nuk ka mbushur moshën 2 muaj dhe mirërritja e saj varet tërësisht dhe në mënyrë ekskluzive nga*

prezenca ime si nënë. Aktualisht fëmija është në proces gjidhënie me kohë të plotë dhe ky proces kushtëzon në mënyrë të domosdoshme nga pikëpamja njerëzore dhe fiziologjike praninë time. Për shkak të këtij procesi si dhe moshës së vogël, fëmija ende nuk ka orare të përcaktuara për ushqim dhe për rrjedhojë prania ime si nënë është e detyrueshme në mënyrë të pandërprerë. Gjykata në të cilën jam caktuar për shkak të distancës nga vendbanimi im në Tiranë e bën të pamundur përkujdesjen ndaj fëmijës në këtë fazë në të cilën ndodhet. Gjithashtu, në rast se Këshilli vlerëson se nuk plotësohen kriteret ligjore për përfitimin e lejes prindërore, dua të sjell në vëmendje se kërkesa për leje të papaguar ka si shkak edhe ndjekjen e studimeve për qëllime kualifikimi profesional, e cila është një nga llojet e lejeve të parashikuara nga ligji, e pavarur nga leja prindërore. Konkretisht në datë 23.06.2022, jam pranuar në Universitetin Western Michigan University Thomas M. Cooley Law School, Lansing, Michigan, në programin JD (Juris Doctor), për të ndjekur studimet full time. Për shkaqe shëndetësore që lidheshin me periudhën e shtatzënisë si dhe për shkaqe familjare që konsistojnë në nevojën për përkujdesjen ndaj fëmijës së mitur, nuk mund të ndjek studimet në muajin Maj 2023, sikundër vijon programi, por do të aplikoj për ndjekjen e tyre në muajin Gusht, në sezonin e vjeshtës. Për këtë qëllim, kërkoj që të më miratohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, leje e papaguar dy vjeçare për të realizuar efektivisht të drejtën për të përfunduar studimet dhe njëkohësisht të kujdesem për vajzën e mitur. E vetëdijshme për situatën aktuale dhe nevojat e sistemit gjyqësor për magjistratë, kërkoj mirëkuptimin e Këshillit në vlerësimin e kësaj situate faktike dhe miratimin nga ana Juaj të lejes së papaguar për një periudhë 2 vjeçare me datë fillimi të lejes nga data 01.06.2023 deri me datë 01.06.2025, duke pasur si konsideratë mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijës, i cili duhet të prevalojë në këtë rast”.

1.3 Për qëllime të vërtetimit të situatës faktike të përshkruar në këtë kërkesë, magjistratja ka paraqitur: *Certifikatë personale të fëmijës së mitur datë 18.04.2023 dhe Vërtetim pranimit në Universitetin Cooley Law School.*

2. PROCEDURA E ZHVILLUAR

2.1 Komisioni për Vlerësimin e Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, zhvilloi procedurën administrative në përputhje me Vendimin Nr. 72 dt. 20.05.2019 “Për lejet e papaguara të gjyqtarëve që jepen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor”.

2.2 Nga informacioni i marrë nga dosja personale e gjyqtarës, rezulton se znj. {...} është emëruar gjyqtare me vendimin nr. 477 dt. 20.10.2020 të KLGJ, dhe është caktuar gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier (ish/Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier) me vendimin nr. 506, dt. 27.10.2020.

2.3 Me vendimin nr. 208, datë 20.05.2021, Këshilli i Lartë Gjyqësor, ka miratuar kërkesën e saj për dhënie leje të papaguar për arsye familjare për një periudhë 1-vjeçare. Leja e sipërcituar është zgjatur me vendimin nr. 200, datë 31.05.2022, deri më datë 01.06.2023.

Shkaqet për të cilën është zgjatur leja, lidheshin me ushtrimin e të drejtës për të krijuar familje.

2.4 Në kushtet kur objekti i kërkesës së znj. {...}, ka qenë i paqartë, pasi fillimisht kërkonte miratimin e lejes së papaguar 2-vjeçare për të realizuar efektivisht të drejtën për të përfunduar studimet, dhe / ose të drejtën që të kujdeset për vajzën e saj të mitur, duke i kërkuar Këshillit të trajtojë me prioritet mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijës, i është kërkuar saktësimi i objektit të kërkesës. Më datë 26.05.2023, znj. {...}, nëpërmjet postës elektronike, është përgjigjur duke saktësuar se kërkesa e saj përmban dy kërkitime të pavarura dhe konkretisht; 1. Leje prindërore, 2. Leje për qëllime kualifikimi dhe specializimi në një institucion trajnimi jashtë periudhës së trajnimit vazhdues.

2.5 Pas përfundimit të procedurës si më sipër, brenda 7 ditëve nga depozitimi i kërkesës së gjyqtares, në mbledhjen e datës 29.05.2023, Komisioni vendosi që kjo çështje t'i kalojë për shqyrtim Mbledhjes Plenare.

2.6 Çështja u morr në shqyrtim në mbledhjen plenare të Këshillit më datë 30.05.2023, brenda afatit 15 ditor nga paraqitja e propozimit në referim të parashikimeve të pikës 6 shkronja “b” të Vendimit nr.72 datë 20.05.2019 të KLGJ.

3. KUADRI LIGJOR I ZBATUESHËM

3.1 Neni 24 i Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikohet se:

“1. Përveç pushimeve vjetore, magjistrati gëzon të drejtën të marrë në përputhje me Kodin e Punës: a) pushime të tjera; b) leje prindërore... 6. Këshilli përcakton rregulla më të detajuara për kriteret dhe procedurat për dhënien e lejes së papaguar.” (neni 24 pika 6 i Ligjit nr. 96/2016).

3.2 Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar vendimin nr.72 datë 20.05.2019 për “Lejet e papaguara të gjyqtarëve që jepen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor”, në të cilin përcaktohen kriteret dhe procedura e dhënies së këtyre lejeve.

3.3 Sa i përket llojit të lejeve të papaguara që jepen nga Këshilli, neni 24 të Ligjit nr.96/2016 dhe Vendimi nr.72 datë 20.05.2019 i Këshillit të Lartë Gjyqësor, në pikën 4 parashikojnë tre lloje të lejes, dhe konkretisht :

- a. Leje prindërore;
- b. Leje për qëllime kualifikimi dhe specializimi në një institucion trajnimi, jashtë periudhës së trajtimit vazhdues;
- c. Leje për arsye familjare dhe/ose shëndetësore;

3.4 Lidhur me kushtet për dhënien e lejes për arsye prindërore, sipas pikës 5 të Vendimit nr. 72, dt. 20.05.2019 “Për lejet e papaguara të gjyqtarëve që jepen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor”, përcaktohet se;

Leja prindërore i jepet nga Këshilli, gjyqtarit që ka ushtruar funksionin më shumë se një vit të pandërprerë, si më poshtë;

a. Për një periudhë jo më pak se 4 muaj dhe jo më shumë se dy vjet në total për çdo fëmijë, derisa fëmija që ka në ngarkim, të arrijë moshën 6 vjeç. Përgjashtimisht për raste (shkaqe) të rënda dhe të motivuara, ky afat mund të zgjatet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

b. E drejta për të kërkuar lejen prindërore është individuale për secilin prind dhe nuk është e transferueshme, me përjashtim të rasteve kur njëri prind vdes. Leja mund të jepet e ndarë, por jo më pak se një javë në vit;

c. Në rastin e birësimit të fëmijës, leja prindërore jepet brenda 6 vjetëve, që nga dita e birësimit të fëmijës, por jo më vonë se kur fëmija mbush moshën 12 vjeç; ç. Gjyqtari që kërkon këtë leje, e paraqet kërkesën me shkrim në Këshill, të paktën 30 ditë para kohës kur kërkon të fillojë kjo leje si dhe përcakton kohëzgjatjen e saj. Bashkë me kërkesën, gjyqtari paraqet dokumentacionin justifikues dhe mendimin me shkrim nga kryetari i gjykatës;

d. Kërkesa e gjyqtarit trajtohet nga Komisioni përkatës, i cili brenda 7 ditëve i përcjell Mbledhjes Plenare propozimin për miratimin e lejes dhe afatin e fillimit të saj. Këshilli merr vendim për këtë kërkesë brenda 15 ditëve nga paraqitja e propozimit. Në vendimin për dhënien e lejes, Këshilli shprehet edhe në lidhje me rihedhjen ose jo në short, të çështjeve që gjyqtari ka në shqyrtim. e. Në rast të cenimit të funksionalitetit apo përmbushjes së detyrës me efikasitet dhe në kohë, Këshilli mund të shtyjë datën e fillimit të lejes deri në 6 muaj. VI”.

4. ANALIZA LIGJORE E ÇËSHTJES

4.1 Nga informacioni i marrë nga dosja personale e gjyqtares, rezulton se znj. {...} është emëruar gjyqtare me vendimin nr. 477 dt. 20.10.2020 të KLGJ, dhe është caktuar gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier (ish/Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier) me vendimin nr. 506, dt. 27.10.2020.

4.2 Me vendimin nr. 208, datë 20.05.2021, Këshilli i Lartë Gjyqësor, ka miratuar kërkesën e saj për dhënie leje të papaguar për arsye familjare për një periudhë 1-vjeçare. Leja e sipërcituar është zgjatur me vendimin nr. 200, datë 31.05.2022, deri më datë 01.06.2023. Shkaqet për të cilën është zgjatur leja, lidheshin me ushtrimin e të drejtës për të krijuar familje.

4.3 Në kushtet kur kjo leje përfundon në datë 01.06.2023, gjyqtarja, ka paraqitur përsëri kërkesë për dhënie leje të papaguar për një periudhë 2-vjeçare. Në kërkesën e saj, znj. {...}, kërkon dhënien e lejes prindërore, duke paraqitur si shkak ardhjen në jetë të vajzës së saj në datë 12.04.2023. Gjithashtu, znj. {...}, në kërkesë ka parashtruar se nëse Këshilli vlerëson që nuk plotësohen kriteret ligjore për përfitimin e lejes prindërore, kërkon miratimin e lejes

së papaguar për qëllime kualifikimi dhe specializimi, në kushtet kur është pranuar për të ndjekur studimet në *Universitetin Western Michigan University Thomas M. Cooley Law School, Lansing, Michigan, në programin JD (Juris Doctor)*.

4.4 Lidhur me kushtet për dhënien e lejes për arsye prindërore, sipas pikës 5 të Vendimit nr. 72, dt. 20.05.2019 “Për lejet e papaguara të gjyqtarëve që jepen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor”, leja prindërore i jepet nga Këshilli gjyqtarit që ka ushtruar funksionin më shumë se një vit të pandërprerë. Nisur nga ky parashikim, znj. {...}, nuk mund të përfitojë leje prindërore të papaguar.

4.5 Nga ana tjetër, ndodhur në kushtet ku shkak i kërkesës së saj është bërë ardhja në jetë e fëmijës (vajzës së saj), e cila aktualisht është në moshën 6-javëshe, Këshilli vlerëson së në këtë rast, në respektim të **parimit të mbrojtjes së interesit më të lartë të fëmijës, i sanksionuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kodin e Familjes, Legjislacionin e marrëdhënieve të punës dhe atë të sigurimeve shoqërore**, leja e papaguar, e kërkuar për këtë arsye, nuk mund të refuzohet.

4.6 Parimi i mbrojtjes së interesit më të lartë të fëmijës sanksionohet në nenin 3 të Konventës së Kombeve të Bashkuara (OKB) për të drejtat e fëmijëve në të cilin përcaktohet se: “*Në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra qoftë nga institucione publike ose private të përkrahjes shoqërore, nga gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjislative, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese.*” . Në respektim të këtij parimi, Kodi i Familjes parashikon dhe rithekson detyrimin për respektimin e interesit më të lartë të fëmijës në një sërë dispozitash të tij ndër të cilat neni 2 parashikon se: “*Prindërit, organet kompetente dhe gjykatat, në vendimet dhe veprimtarinë e tyre, duhet të kenë si konsideratë parësore interesin më të lartë të fëmijës*”.

4.7 Në kuadër të garantimit të mbrojtjes së interesit më të lartë të fëmijës, të sanksionuar në Kushtetutë dhe në instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e fëmijëve, ligjvënësi me qëllim përafrimin e legjislacionit me Direktivat e BE-së, ka ndryshuar Kodin e Punës me ligjin 136/2015, i cili ka hyrë në fuqi në datë 22.06.2016, duke parashikuar;

- Ndalimin e punës për gratë shtatzëna dhe nënat e reja, neni 104. Nga përmbajtja e kësaj dispozite, qartazi përcaktohet që grave shtatzëna, 35 dite para lindjes dhe 63 ditë pas lindjes, *ju ndalohet të punojnë*. Pas përfundimit të kësaj periudhë, gruaja që sapo ka lindur dhe /ose gruaja me fëmijë në gji, **vendos vetë nëse do të shkojë në punë**.
- Gjithashtu, në nenin 27/2 të ligjit nr. 7703, dt 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet se: “*Periudha e përfitimit nga barrëindja do të jetë 365 ditë kalendarike, duke përfshirë një minimum prej 35 ditë para dhe 63 ditë pas lindjes së fëmijës*”. Kështu ligji parashikon se periudha e përfitimit nga paaftësia për shkak të barrëindjes është derisa fëmija të mbushë 11

muaj. Në frymën e këtij përcaktimi interesi më i lartë i fëmijës kërkon domosdoshmërinë e kujdesit amësor deri në një periudhë 11 mujore pas ardhjes në jetë të fëmijës.

- Lejen Prindërore, neni 132/1 si të drejtë vetjake (e patransferueshme) të punëmarrësit, që nuk mund t'i refuzohet nga punëdhënësi, nëse punëmarrësi plotëson kushtet e dispozitës dhe që duhet konceptuar si mundësi e prindit për t'iu përkushtuar në kohë fëmijës që rritet.

4.8 Sa më sipër, arrihet në konkluzionin se nëna më fëmijë të mitur, ka të drejtën e garantuar nga Kushtetuta, aktet ndërkombëtare të pranuar, dhe të kujdeset për të legjislacioni i brendshëm për mbrojtjen shoqërore, të qëndrojë me fëmijën e mitur dhe të kujdeset për të derisa ai të mbushë 11 muaj. Në rastin konkret, gjyqtarja nuk i plotëson kushtet sipas ligjit për sigurimet shoqërore, pasi sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 ‘Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë’, i ndryshuar parashikohet se: ... *“E ardhura për barrë lindje i paguhet gruas së siguruar për barrën dhe lindjen e fëmijës, kur ajo ka 12 muaj periudhë sigurimi, për çdo rast përfitimi”*, thjesht për të përfituar pagesë për leje lindje por, **kjo situatë nuk mund t'i heqë asaj të drejtën** për të qëndruar pranë fëmijës, derisa ai të mbushë 11 muaj.

4.9 Këshilli vlerëson se gjyqtarja nuk është në kushtet e përfitimit të lejes prindërore pasi për këtë kategori ligji ka parashikua ekzistencën e një viti pune të pandërprerë. Duke qenë se jemi përpara një situatë specifike, ku kërkuesja ndodhet në kushtet e përkujdesjes së fëmijës së sapo sjellë në jetë (6/javë), por të pamundësisë për tu trajtuar me leje prindërore për shkak të mospasjes së periudhës 1/vjeçare të qenies në marrëdhënie pune, kërkesa e saj do të trajtohet bazuar në Kushtetutë dhe dispozitat e mësipërme të K.Punës.

4.10 Në analizë të parashtrimeve të mësipërme, Këshilli, vlerëson se: gjyqtare {...}, duhet të trajtohet me leje të papaguar për një afat 11 mujor për shkak të lindjes së fëmijës, dhe të ushtrimit të së drejtës parësore për të ruajtur dhe garantuar jetën dhe shëndetin e fëmijës. Pavarësisht se znj. {...} ka ezauruar periudhën 2 vjeçare të lejes për arsye familjare, gjendja faktike, ardhja në jetë e fëmijës, duhet trajtuar në frymën e garancive kushtetuese për të mbrojtur interesin më të lartë të fëmijës. Në situatën faktike interesi më i lartë i fëmijës dikton kujdesin e pashmangshëm të nënës si në aspektin e nevojave fiziologjike, ushqimit me gji, ashtu edhe në aspektin e nevojave emocionale të fëmijës dhe nënës gjithashtu. Duke pasur në vëmendje specifikat e lejes së papaguar e cila në thelb aplikohet për të garantuar ruajtjen e vendit të punës për gjyqtarin, gjykohet se për shkak të interesit më të lartë të fëmijës, gjyqtares duhet t'i garantohet e drejta për ruajtjen e pozicionit dhe sigurisht të lejohet të ushtrojë funksionin primar të kujdesit ndaj fëmijës.

4.11 Pavarësisht gjendjes së sistemit për shkak të vakancave të krijuara, Këshilli vlerëson se, leja e papaguar për gjyqtaren nuk mund të kushtëzohet nga cenimi apo jo i

funksionalitetit të gjykatës ku ushtron detyrën gjyqtarja apo nga mendimi me shkrim të zv/kryetares të gjykatës. **Gjyqtarja e përfiton këtë të drejtë pa asnjë kusht, derisa fëmija të mbushë 11 muaj.**

4.12 Këshilli vlerëson gjithashtu, edhe pse znj. {...} ka ezauruar periudhën 2-vjeçare të lejes së papaguar për arsye familjare, sipas përcaktimeve të pikës 8 të Vendimit nr. 72, dt. 20.05.2019 “Për lejet e papaguara të gjyqtarëve që jepen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor”, në kushtet kur referuar legjislacionit të sipërcituar, kjo situatë nuk mund t’i heqë asaj të drejtën për të qëndruar pranë fëmijës, derisa ai të mbushë 11 muaj, pasi është nëna ajo që vendos të punojë ose jo gjatë kësaj periudhe. Në respektim të parimit të mbrojtjes së interesit më të lartë të fëmijës, i sanksionuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kodin e Familjes, Legjislacionin e marrëdhënieve të punës dhe atë të sigurimeve shoqërore, leja e papaguar nuk mund të refuzohet derisa fëmija të bëhet 11 muaj.

4.13 Në rastin konkret “leja e papaguar”, nuk përbën “leje prindërore” dhe as zgjatje e afatit të lejes të dhënë më herët për arsye familjare, tej atij 2/vjeçar, të parashikuar nga neni 24 i Ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në R.Shqipërisë”, i ndryshuar. Këshilli ka detyrimin pozitiv të parashikuar nga neni 54 i Kushtetutës t’i garantojë mbrojtje të veçantë gjyqtares si nënë e re, por edhe fëmijës së sjellë në jetë prej saj. Në referim të neneve 104 dhe 105 të K.Punës, duke përfshirë edhe periudhën 35/ditore para lindjes, kjo mbrojtje nuk mund të zgjasë më shumë se 365 ditë kalendarike, ose më shumë se 11 muaj pas lindjes së fëmijës, në kushtet kur nëna(gjyqtarja) nuk dëshiron të punojë. Nga kjo e drejtë nuk mund të diskriminohen nënat e reja të cilat nuk përfitojnë nga skema e sigurimeve shoqërore (leja e lindjes). Në kushtet kur gjyqtarja kërkon të vazhdojë përkujdesjen për fëmijën e saj të mitur, me qëllim garantimin e interesit më të lartë të fëmijës, Këshilli nuk mund ta refuzojë kërkesën e saj për këtë qëllim, pavarësisht kualifikimit jo të saktë ligjor të bërë në kërkesë si “leje prindërore”. Kjo leje ka natyrën e “lejes së papaguar”, sepse për këtë periudhë gjyqtarja nuk përfiton pagë dhe as të ardhura të tjera nga ligji për sigurimet shoqërore.

4.14 Trajtimi i kërkesës së gjyqtares për dhënien e lejes së papaguar për një afat 11/mujor nga lindja e fëmijës, e bën të panevojshëm trajtimin e kërkesës që për të njëjtën periudhë kohore, gjyqtares t’i jepet leje e papaguar edhe për arsye specializimi.

5. KONKLUZIONI

Për sa arsyetohet më lart, Këshilli vlerëson se kërkesa e gjyqtares {...} për dhënie leje të papaguar, duhet miratuar për periudhën nga data 01.06.2023 deri në datë 12.03.2024. Në lidhje me të drejtën e ankimit, në referim të parashikimeve të nenit 100 të Ligjit nr.115/2016, ndryshuar me ligjin nr. 47/2016, kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e njoftimit të vendimit.

PËR KËTO ARSYE

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbështetje të nenit 54 të Kushtetutës së R.Shqiperisë, nenet 104 dhe 105 të K.Punës, nenet 61, 68 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” të ndryshuar, nenin 24, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Vendimin nr. 72, datë 20.05.2019 “Për lejet e papaguara të gjyqtarëve që jepen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor”, bazuar në kërkesën e gjyqtarës {...} datë 23.05.2023,

VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës së znj. {...}, gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, për dhënie leje të papaguar për periudhën nga data 01.06.2023 deri në datë 12.03.2024.
2. Njoftimin e këtij vendimi gjyqtarës {...} dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga e nesërmja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimitetit.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR